VENDIM
Nr. 639, datë 5.10.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "HEKURUDHAT SHQIPTARE – REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE TIRANË–DURRËS DHE NDËRTIMI I LINJËS HEKURUDHORE PËR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS", NË KUADËR TË GRANTIT TË INVESTIMIT NGA FONDI I PËRBASHKËT EVROPIAN I BALLKANIT PERËNDIMOR, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 52/2018

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit "Hekurudhat shqiptare – Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës", në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor, ratifikuar me ligjin nr. 52/2018, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LOGOJA E EBRD-së

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bul. Dëshmorët e Kombit 3
Tiranë
SHQIPËRI

Drejtuar: Ministrit të Financave dhe Ekonomisë

Faks: + 355 4 222 8494

8 nëntor 2021

Të nderuar Zotërinj,

Lënda: Hekurudhat Shqiptare
Veprimi Nr. 48466

1. Ju lutem referojuni:

(i) marrëveshjes së huasë të datës 29 dhjetor 2016 ("Marrëveshja e Huasë") ndërmjet Republikës së Shqipërisë ("Huamarrësi") dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka");

(ii) Termave dhe Kushteve Standarde ("ST&C") të datës 1 dhjetor 2012 që përbëjnë pjesë integrale të Marrëveshjes së Huasë;

(iii) marrëveshjes së projektit të datës 17 maj 2017 ("Marrëveshja e Projektit") ndërmjet Hekurudha Shqiptare SH.A. ("Njësia e Projektit") dhe Bankës; dhe

(iv) Marrëveshjes së Grantit të datës 7 maj 2018, të ndryshuar nga Amendamenti i Marrëveshjes nr. 1, datë 19 shtator 2019 ("Marrëveshja e Grantit") ndërmjet Huamarrësit (në cilësinë e tij si "Përfituesi") dhe Bankës;

2. Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë, ST&C, Marrëveshjen e Projektit dhe Marrëveshjen e Grantit kanë të njëjtat kuptime kur përdoren në këtë shkresë, përveç nëse parashikohet ndryshe ose kur konteksti kërkon ndryshe. Referencat në këtë shkresë për një klauzolë janë për klauzolën e specifikuar të kësaj shkrese.

3. Seksioni 2.02(f) i Marrëveshjes së Huasë thekson se Data Përfundimtare e Vlefshmërisë do të jetë data katër vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje apo një datë më e vonshme që Banka, me kërkesë të Huamarrësit dhe me diskrecionin e saj, mund të caktojë dhe njoftojë Huamarrësin.

4. Seksioni 2.02(a) i Marrëveshjes së Huasë thekson se e drejta e Marrësit për të kërkuar një disbursim në përputhje me këtë Marrëveshje, do të hyjë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi dhe do të përfundojë në datën më të hershme të (i) datës përfundimtare të disponueshmërisë për kredinë e Bankës për Projektin (siç përshkruhet në Marrëveshjen e Huasë) të specifikuar në Seksionin 2.02 (f) (Kushtet e tjera financiare të huasë) të Marrëveshjes së Huasë ose (ii) 31 dhjetor 2025, ose një datë tjetër të mëvonshme që Banka, sipas gjykimit të saj dhe me marrëveshjen e Përfituesit, mund të vendosë dhe njoftojë Marrësin.

5. Më 8 nëntor 2021, me anë të një shkresë të veçantë, Banka ra dakord të zgjasë Datën Përfundimtare të Disponueshmërisë të specifikuar në seksionin 2.02(f) të Marrëveshjes së Huasë deri më 20 dhjetor 2025.

6. Si rrjedhoje, Banka pranon të zgjasë datën përfundimtare të disponueshmërisë për huanë e Bankës të specifikuar në seksionin 2.02(a) të Marrëveshjes së Grantit deri më 20 dhjetor 2025.

7. Përmbajtja e kësaj shkrese nuk do të cenojë asnjë të drejtë, fuqi ose mjet juridik të Bankës në lidhje me ndonjë kusht tjetër sipas Marrëveshjes së Huasë dhe as nuk do të interpretohet si heqje dorë prej saj ose pranim të saj.

Me respekt,

Azmat Khurshid
Drejtor i Asociuar
Departamenti i Administratës Operative

Rënë dakord dhe pranuar nga Huamarrësi:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____
Emri:
Pozicioni

Nga: _____
Emri:
Pozicioni